

Taksa e paguar

AKT THEMELIMI
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ISOBAR CONSTRUCTION" Shpk.

Sot me daten 06 Tetor 2011 (dy mije e njembdhjete) para meje noteres Nexhla Q.KELLEZI, me Zyre ne Noterine e Tirane, ne Bulevardin "Gjergj Fishta" Kulla 1, pall. E Shoqerise » Gora » sh[k, ne katin e pare , u paraqit personalisht :

ALBAN TARELLI, i biri i Bilbilit, i datelindjes 08.05.1977, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, Lagjia Nr 1, Rr. "Epikadeve", pall 18, shk 1, ap 1, qytetar shqiptar, i indentifikuar me Pasaporte Nr BA6202122, me madhor e me zotesi te plote per te vepruar, ne baze te legjislacionit shqiptar vendos:

Neni 1

Te themeloje nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar per te ushtruar veprimtarine ekonomike, e emertuar "**ISOBAR CONSTRUCTION**".

Neni 2

Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive Tregtare me Pergjegjesi Te Kufizuar dhe perballon humbjet sipas ligjeve ne fuqi.

Neni 3

Shoqeria e ka seline e saj ne Yzberisht, ish-Frigoriferi, pall firmes "Lorena" shpk, Seksioni B, shk 1, kati 2, ap 2, Tirane. Ajo ka te drejte te krijojte brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, filjale, agjensi perfaqesimi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato.

Neni 4

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje me kufi te pacaktuar e mbi 10 vjet ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke. Ky kapital eshte i ndare ne 100 kuota, secila prej tyre ka vleren 1 000 (njemije) leke.

Kuotat e kapitalit themeltar te shoqerise i perkasin teresisht Ortakut te Vetem.

Neni 6

Ne librin e llogarise se shoqerise do te krijohet "Fondi Themelor i Ortakut te Vetem".

Rritja e kapitalit te ortakut nuk eshte e kufizuar.

Neni 7

Te gjitha pjeset e kapitalit themelor jane teresisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga ortaku i vetem i shoqerise.

Neni 8

Objekti I aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete ne fushen e:

- Aktivitet ne fushen e ndertimit dhe projektimit.
- Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport, tregtim te materialeve te ndryshme, tregtim produktesh te gatshme dhe gjysem te gatshme, me shumice dhe pakice, tregtim artikuj sportive dhe argetimi, materiale kancelarie, transport dhe tregtim te produkteve bujqesore e blegtoriale, fruta-perime si edhe mallra te tjere ushqimore. Autoservis, tregtim te makinerive te ndryshme e pjese kembimi per to.

Shoqeria do te ushtroje cdo aktivitet ndihmes ne perputhje me legjislacionin shqiptar i cili i sherben aktivitetit te saj kryesor.

Neni 9

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet Kontrates se Punesimit qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 7961 date 12.07.1995 (Kodi i Punes), si dhe akteve te tjera nenligjore te dala ne zbatim te tij.

Neni 10

Shoqeria gjate ushtrimit te aktivitetit te saj mund te zmadhoje ose te zvogeloje kapitalin themelor, ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 11



Shoqeria vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta dhe detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaku i vetem themelues mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit themeltar te investuar ne shoqeri.



Neni 12

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, midis punonjesve te saj, si dhe me te tretet, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, ceshtja mbetet ne kompetence te Gjykates se Rrethi Gjyqesor Tirane.

Neni 13

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar emri dhe inicialet e formes se saj ligjore.

Neni 14

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet prane Shoqerive te Sigurimeve.

Neni 15

Shoqeria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit te percaktuar ne kete kontrate ose per shkaqe te perligjura qe gjykohen te tilla nga ortaku.

Neni 16

Organet e shoqerise "**ISOBAR CONSTRUCTION**"sh.p.k, jane:

- Ortaku i Vetem i shoqerise.
- Administratori i shoqerise.

~~Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne Statutin e Shoqerise.~~

Administrator i shoqerise eshte **Alban Tarelli, I cili caktohet per nje periudhe pesevjecar.**

Modalitetet per ndryshimin e Administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti i Shoqerise dhe Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".



Ky Akt-Themelim eshte perpiluar dhe firmosur ne tre kopje me vlere te njejte me origjinalin, nga te cilat nje depozitohet ne zyren e noterit, nje tjeter ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe nje tjeter mbahet ne dokumentacionin e shoqerise.

Sa me siper eshte nje akt themelimi i shoqerise me vullnetin e plote e te lire te ortakut te vetem te shoqerise, i cili pasi e lexoi, e miratoi e firmosi qte rregullisht para meje noteres dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjes

ORTAKU I VETEM THEMELUES

ALBAN TARELLI

ALBAN TARELLI



NOTERE
Nexhla Q. KELLEZI

Nexhla Q. KELLEZI

STATUT

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ ISOBAR CONSTRUCTION ”



(Hartuar ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008,“Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”).

Shoqeria “ **ISOBAR CONSTRUCTION** ” shpk, eshte krijuar mbi bazen e Akt - Themelimit te Ortakut te Vetem, **Z. Alban Tarelli**, i biri i Bilbilit, i datelindjes 08.05.1977, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, Lagjia Nr 1, Rr. “Epikadeve”, pall 18, shk 1, ap 1, qytetar shqiptar, i indentifikuar me Pasaporte Nr BA6202122, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, per te zhvilluar aktivitetin tregtar, i cila ka vendosur te perpiloje kete Statut si me poshte:

Neni 1

Emertimi

Shoqeria eshte quajtur “**ISOBAR CONSTRUCTION**” shpk.

Ajo eshte subjekt juridik shqiptar dhe ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit te saj. (Akt –Themelimi dhe Statuti).

Ortaku i vetem themelues ne kete sipermarrje ka derdhur kapitalin e tij me qellim qe te perfitoje te ardhura, qe mund te vijne nga ushtrimi i veprimtarise private. Ai perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se derdhur ne kapitalin themelor.

Neni 2

Objekti

Objekti i aktiviteti ekonomik te shoqerise eshte:

- Aktivitet ne fushen e ndertimit dhe projektimit.
- Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport, tregtim te materialeve te ndryshme, tregtim produktesh te gatshme dhe gjysem te gatshme, me shumice dhe pakice, tregtim artikuj sportive dhe argetimi, materiale kancelarie, transport dhe tregtim te produkteve bujqesore e blegtoriale, fruta-perime si edhe mallra te tjere ushqimore. Autoservis, tregtim te makinerive te ndryshme e pjese kembimi per to.

Shoqeria do te ushtroje cdo aktivitet ndihmes ne perputhje me legjislacionin shqiptar i cili i sherben aktivitetit te saj kryesor.

Neni 3

Selia

Shoqeria “**ISOBAR CONSTRUCTION**” shpk e ka seline e saj Yzberisht, ish-Frigoriferi, pall firmes “Lorena” shpk, Seksioni B, shk 1, kati 2, ap 2, Tirane.

Ajo ka te drejte te krijojë brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise filiale, agjensi, perfaqesi, seli sekondare dhe ti suprimoje ato.

Neni 4

Kohegzjatja e Shoqerise

Shoqeria tregtare **"ISOBAR CONSTRUCTION"** do te kete nje kohegzjatje te veprimtarise se saj ekonomike me nje afat te pacaktuar.



Neni 5

Kapitali I Shoqerise

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke, i perbere nga 100 kuota me vlere nominale 1.000 leke secila dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise. Kapitali i shoqerise mund te ndryshoje sipas vendimit qe do te marre Ortaku I Vetem, ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 6

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarje pasurore ndermjet bashkeshorteve, paraardhesve e pasardhesve. Ne rast vdekjeje te ndonjerit prej ortakeve pjesa e kapitalit qe ai disponon i kalon te trashegimtarete e tij dhe kur asnjeri nga pjestaret e familjes nuk pranon te punoje ne ortakeri, atehere u jepen te gjitha fitimet qe ju takojne sipas kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar.

Te gjitha pjeset e kapitalit te shoqerise mund t'u kalojne, t'u transferohen personave te trete, qe nuk bejne pjese ne ortakeri sipas menyrave te percaktuar ne ligj. Ne rastin e kalimit te kutova me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Trashegimtari hyn ne shoqeri me te gjitha te drejtat e ortakut dhe me te gjitha efektet.

Neni 7

Kapitali i Shoqerise perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe te tjera te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Neni 8

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarise ekonomike i Shoqerise do te administrohet nga Ortaku i Vetem. Nje pjese te ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqeria eshte e detyruar te shlyeje te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve.

Neni 9

Shoqeria eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje te drejta te tjera materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se saj tek te tjeret, te tretet.

Ne Republiken e Shqiperise Shoqeria Tregtare **" ISOBAR CONSTRUCTION "** shpk gezon te drejta sikunder cdo person tjeter juridik dhe fizik shqiptar ose i huaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 10

Organizimi Dhe Administrimi Ne Shoqeri

Organi vendimarrës i shoqerise eshte Ortaku i Vetem.

Ortaku i Vetem ka te drejte per te vendosur per ceshtje te tilla si: percaktimi i politikave tregtare te shoqerise, emerimi ose shkarkimi i administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive, ndarja e fitimit, zvogelimi i kapitalit themelor ose zmadhimi i tij, transferimi i pjeseve te kapitalit themelor te te tretet, zgjatja e afatit te veprimtarise se shoqerise apo likuidimi i saj, shnderrimi i shoqerise ne

nje forme tjeter, ne nje nga format e parashikuara nga ligji, ndryshimi i statutit e te tjera ceshtje te parashikuara nga ligji.

Neni 11

Ortaku i Vetem mbledhjet e zakonshme i ben cdo vit brenda 6 muajve nga mbyllja e veprimtarise ekonomike te shoqerise.



Neni 12

Administratori

Shoqeria administrohet nga **Z. Alban Tarelli**.

Administratori qendron per nje periudhe 5 vjecare ne detyre, me te drejte rizgjedhjeje. Ortaku i Vetem gezon te drejten ne cdo kohe te shkarkoje nga detyra administratorin dhe te emeroje nje tjeter ne vend te tij.

Administratori ka keto kompetenca:

- Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga ortaku.
- Perfaqeson shoqerine tregtare.
- Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te librave kontabel te shoqerise.
- Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor te shoqerise brenda dates 31 mars, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimit te cilat i paraqiten ortakut per miratim.
- Kryen detyra te tjera te percaktuar ne ligj.

Neni 13

Viti Financiar, Llogarite Vjetore

Administratori parashikon brenda 31 marsit perfundimin e paqyrave financiare duke ia paraqitur ortakut te vetem per miratim.

Neni 14

Cdo vit financiar fillon me 1 janar te cdo viti dhe perfundon me 31 dhjetor, me perjashtim te vitit te pare ku si fillim eshte data e regjistrimit te shoqerise.

Neni 15

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret, apo nga ekspertet kontabel, miratohen nga Ortaku i Vetem. Miratimi i dokumentave financiare vjetore behet brenda nje afati 3-mujor, mbas dates se mbylljes se vitit financiar.

Neni 16

Mbas miratimit te llogarive vjetore Ortaku i Vetem mund te vendose shperndarjen e fitimit ne forme divdenti ne perputhje me nenin 77 te ligjit Nr 9901.

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se sigurimeve shoqerore, dhe detyrimeve te tjera. Ajo ka te drejte te cele llogari likuiduese prane bankave te vendit dhe te kryeje veprime likuidimi me to.

Neni 17

Marredheniet E Punesimit

Marredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen nepermjet Kontrates se Punesimit, qe lidhet midis paleve ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, i cili ben fjale per punesimin.

Neni 18

Largimi nga puna behet me mbarimin e kontrates se punes, per shkelje disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit.

Largimi nga shoqeria behet mbasi jane shlyer te gjitha detyrimet materiale dhe monetare.

Neni 19

Dispozita Te Tjera Te Pergjithshme

Shoqeria mund te prishet para afatit te caktuar ne kete statut, ne rastet kur ndryshon afati ose kur ka nje prishje te parakoheshme per shkaqe te tjera.

Neni 20

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi emerohen nje ose disa likuidatore te cilet ndjekin operacionet e likuidimit deri ne fund dhe i paraqesin Ortakut te Vetem rezultatet perfundimtare te likuidimit. Ne perfundim Ortaku i Vetem vendos per heqjen e mandatit te tyre. Te gjitha detyrimet qe dalin nga likuidimi Ortaku i Vetem i merr persiper per ti shlyer me kapitalin e tij te investuar ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 21

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te kalojne ne kompetence Gjykates.

Neni 22

Shnderrimi i shoqerise ne nje shoqeri tjeter behet me vendim te Ortakut te Vetem, kur plotesohen kushtet per krijimin e shoqerive te llojeve te tjera.

Neni 23

Themeluesi i Shoqerise mund te beje ndryshime e plotesime ne cdo kohe ne Statut dhe ne Aktin e Themelimit pa rene ndesh ne menyre thelbesore me nenet e pershkuara ne kete Statut.

Neni 24

Ceshtjet e tjera qe nuk trajtohen ne kete statut zgjidhen ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", i ndryshuar, si dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Ky Statut eshte perpiluar dhe firmosur ne tre kopje me vlere te njejte me origjinalin, nga te cilat nje depozitohet ne zyren e noterit, nje kopje depozitohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe nje tjeter mbahet ne dokumentacionin e shoqerise.

ORTAKU I VETEM I THEMELUES

ALBAN TARELLI

ALBAN TARELLI



REPUBLIKA E SHQIPERIS
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr 1326 Rep.

Nr 369 Kol.



VERTETIM NENESHKRIMI

Sot me daten 06 Tetor 2011 (dymije e njembdhjete) para meje noteres, Nexhla Q. KELLEZI, ne Dhomen e Noterise Tirane, me Zyre ne Bulevardin "Gjergj Fishta" Kulla 1, u paraqit personalisht :

ALBAN TARELLI, i biri i Bilbilit, i datelindjes 08.05.1977, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, Lagjia Nr 1, Rr. "Epikadeve", pall 18, shk 1, ap 1, qytetar shqiptar, i indentifikuar me Pasaporte Nr BA6202122, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, ortaku i vetem i shoqerise "ISOBAR CONSTRUCTION" shpk, i cili me deklaroi se sa me siper eshte Statuti i Shoqerise se tij, eshte bere me vullnetin e plote e te lire te tij, jashte kesaj zyre, e firmosi ate rregullisht para meje noteres dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjes.

petersonjoffu
02.10.2015
Mj 2011

PULLE TAKSE



PULLE TAKSE



NOTERE
Nexhla Q. KELLEZI

Nexhla Q. Kellezi
Mj 2011